



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 28 dhjetor 2021
Nr.ref.:RK 1928/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI186/21

Parashtrues

Faik Miftari

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimit të Ministrisë së
Financave, Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Kosovës nr. 58/2021 të
29 shtatorit 2021 për kriteret dhe kushtet për marrjen e ndihmës –
mbështetjes për familjet që kanë humbur një anëtar të familjes nga
COVID-19.**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Faik Miftari nga Prizreni (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston vendimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Kosovës nr. 58/2021 të 29 shtatorit 2021 për kriteret dhe kushtet për marrjen e ndihmës – mbështetjes për familjet që kanë humbur një anëtar të familjes nga COVID-19.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se qytetarëve të Republikës së Kosovës u është shkelur dinjiteti si dhe të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 26 [E Drejta e Integritetit Personal] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 tetor 2021, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 25 tetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 25 tetor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 11 nëntor 2021, Gjykata njoftoi Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Kosovës lidhur me kërkesën dhe të njëjtës ia dërgoi një kopje të kërkesës.
9. Më 16 nëntor 2021, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë një kopje të vendimit të kontestuar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Kosovës.
10. Më 25 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një kopje të vendimit të kontestuar.
11. Më 10 dhjetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 28 shtator 2021, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Kosovës nxori vendimin e Ministrit të Financave të Qeverisë së Kosovës nr. 58/2021 të 29 shtatorit 2021, për kriteret dhe kushtet për marrjen e ndihmës – mbështetje për familjet që kanë humbur një anëtar të familjes nga COVID-19.
13. Më 20 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës e kontestoi kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Kosovës është nxjerrë në kundërshtim me dinjitetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës si dhe me të drejtat dhe liritë e tyre themelore të garantuara me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 26 [E Drejta e Integritetit Personal] të Kushtetutës.
15. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë pretendon se vendimi i kontestuar, *“ka bërë diskriminimin e qytetareve të Republikës së Kosovës, ashtu që ka bërë segregacion, ndarje të qytetarëve në bazë të statusit tjetër personal, gjegjësisht në bazë të gjendjes së tij shëndetësore, në qytetar të vaksinuar dhe të pavaksinuar”*.
16. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon, *“Sipas nenit 113.7 si parashtrues i kësaj kërkesë mund të jem i prekur nga vendimi i sjellur i ministrit të financave z. H. M., pasi që edhe unë vet mund të jem kandidat potencial i cili mund të sëmurem dhe si pasojë e virusit COVID-19, edhe të vdes, ndërsa familjarët e mi të mos kenë rast të marrin kompensimin nga pakoja mbështetëse vetëm pse nuk jam vaksinuar”*.
17. Parashtruesi i kërkesës pretendon, *“Pasi që vendimi i ministrit të financave është një akt juridik i përgjithshëm të cilin nuk mund ta atakoj në gjyqësor nëpërmes mjeteve të rregullta juridike, kërkoj nga Gjykata e respektuar Kushtetuese që shkeljet e lirive dhe drejtave njerëzore të bëra nga ministri i financave z. H. M të vlerësoni kushtetutshmërinë e këtyre shkeljeve të pretenduara. pa i shtjerur mjetet juridike në procedure gjyqësore”*.
18. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendon, *“Sipas interpretimit të GjEDNJ, unë si parashtrues i kësaj kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij vendimi të ministrit të financave z. H. M. mund të jem viktimë serioze e shkeljes së autoritetit publik të Kosovës”*.

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata, së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1, 7 dhe 8 dhe të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

8. Gjykatat kanë të drejtë t’i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

21. Gjykata gjithashtu i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

22. Gjykata më tej vlerëson nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në rregullin 39 (1) (a) dhe (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

- (a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar,*
- (b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar”*

23. Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e vendimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Kosovës lidhur me kushtet formale për marrjen e ndihmës - mbështetjes për familjet që kanë humbur një anëtar të familjes nga COVID-19. Në këtë drejtim, ai kërkon nga Gjykata që të interpretojë Vendimin e Qeverisë, konkretisht të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, duke pretenduar se (i) vendimi i kontestuar diskriminon qytetarët e Republikës së Kosovës duke i ndarë në qytetarë të vaksinuar dhe të pa vaksinuar; dhe (ii) edhe unë mund të jem personalisht viktimë e një shkeljeje kushtetuese, duke pasur parasysh rrezikun real dhe të sëmurem e madje të vdes nga pasojat e virusit COVID-19, ndërkohë që familjarët e mi nuk kanë mundësi të marrin kompensim nga pakoja mbështetëse vetëm sepse nuk jam vaksinuar.

(I) A është parashtruesi i kërkesës palë e autorizuar të kontestojë vendimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Qeverisë së Kosovës në emër të të gjithë qytetarëve të Kosovës

24. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“vendimi i kontestuar ka bërë diskriminimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, ashtu që ka bërë ndarje në qytetar të vaksinuar dhe të pavaksinuar”.*

25. Përndryshe, sa i përket kërkesës së parashtruesit për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, Gjykata thekson qëndrimin e saj konsistent se personat fizikë apo juridikë nuk janë palë të autorizuar për të kërkuar vlerësimin abstrakt të përputhshmërisë së vendimeve të autoritetit publik me Kushtetutën ose kërkesat e natyrës *actio popularis*. Prandaj, Gjykata ka theksuar vazhdimisht në praktikën e saj gjyqësore se individët nuk mund të kontestojnë *in abstracto* aktet normative të një natyre të përgjithshme.

26. Në këtë drejtim, Gjykata në veçanti i referohet vendimit të saj në rastin KI17/19, ku parashtruesit kërkuan vlerësimin e kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Në atë rast, Gjykata arsyetoi se parashtruesit e kërkesës *„në asnjë mënyrë nuk kanë dëshmuar se si akti i kontestuar ka cenuar të drejtat dhe liritë e tyre themelore”* dhe *“se teksti kushtetues dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate nuk ua njohin të drejtën individëve që të kontestojnë in abstracto akte të karakterit të përgjithshëm”*. Rrjedhimisht, Gjykata e kishte deklaruar si të papranueshme kërkesën e parashtruesve për vlerësim të kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ, pasi që kërkesa nuk ishte parashtruar nga një palë e autorizuar siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës nr. KI17/19, parashtrues: Zymer Neziri, Rexhep Doçi, Daut Bislimi, Xheladin Shala, Adem Zejnullahu, Exhlale Dobruna, Mehmet Ahmetaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpages sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional të Ministrisë së

Punës dhe Mirëqenies Sociale”, Aktvendim për papranueshmëri i 9 korrikut 2020, paragrafët 30-34).

27. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata nuk sheh ndonjë rrethanë apo arsye të vendosë ndryshe nga praktika e saj e gjyqësore në raste të ngjashme.
28. Gjykata përsërit faktin se Kushtetuta nuk parasheh të drejtën e individëve që të paraqesin kërkesë për kontroll kushtetues abstrakt, gjegjësisht t'i kontestojnë drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese aktet e përgjithshme normative të autoriteteve publike. Kushtetuta ofron mbrojtje për individët sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike, vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës. Këto dispozita kushtetuese kërkojnë nga parashtguesit e kërkesave kushtetuese që të dëshmojnë se: (1) janë palë të autorizuar; (2) janë të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret ose mosveprimi i autoriteteve publike; dhe (3) kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. (Shih, për këtë qëllim, mes autoriteteve tjera, rastet e Gjykatës: KI21/19, parashtgues *Pjetër Boçi*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 majit 2019 – ku ishte kërkuar interpretim i legjislacionit relevant në lidhje me përkufizimin e “pozitës zyrtare”, paragrafët 21-28 dhe referencat e cituara aty; KI92/12 *parashtgues Sali Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2012 – ku ishte kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Pensionet; KI62/12 *parashtgues Liridon Aliu*; Aktvendim për papranueshmëri i 20 shtatorit 2012 – ku ishte kërkuar interpretim i Kushtetutës; KI40/11 *parashtgues Zef Prenaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2011 – ku ishte kërkuar vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 11/2010 për pagesën e pensionit themelore të nxjerrë nga MPMS në tetor të vitit 2010).
29. Pra, sipas dispozitave relevante të Kushtetutës (neni 113.7) dhe të Ligjit (nenet 47 dhe 49), e vetmja mënyrë se si personat fizikë ose juridikë mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji në Gjykatën Kushtetuese është nëse ata dëshmojnë se kërkesa e tyre nuk është e karakterit “*actio popularis*” – por që ata janë prekur nga një “ligj” në mënyrë të drejtpërdrejtë, në mungesë të ndonjë akti, vendimi ose mase që zbaton atë ligj. Në rrethanat e rastit konkret, siç u shpjegua më lartë, kjo nuk kishte ndodhur.
30. Prandaj, Gjykata vëren se nuk mund t'u përgjigjet pyetjeve dhe dyshimeve në lidhje me zbatimin e vendimit të kontestuar të cilin parashtguesi i kërkesës e ka paraqitur në mënyrë abstrakte në kërkesën e tij.

(II) A i ka shteruar parashtguesi i kërkesës të gjitha mjetet juridike në lidhje me shkeljen e pretenduar të drejtave dhe lirive kushtetuese në bazë të veprimeve të autoriteteve publike të ndërmarra në zbatimin e vendimit të kontestuar

31. Gjykata rikujton se parashtguesi i kërkesës gjithashtu ankohet edhe për efektet e masës së ndërmarrë nga Qeveria përmes vendimit të kontestuar, sipas të cilit, në rast të vdekjes së tij të shkaktuar nga Covid 19, familja e tij nuk do të mund të marrë kompensim nga pakoja mbështetëse thjesht sepse ai ka nuk është vaksinuar. Rrjedhimisht, parashtguesi i kërkesës preket drejtpërdrejt nga vendimi i kontestuar, në formën e veprimeve të autoriteteve publike.

32. Në lidhje me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata konsideron se Ligji për Konfliktet Administrative nr. 03/L-202 (në tekstin e mëtejshëm: LKA), ofron mjete juridike për zgjidhjen e rastit të parashtruesve të kërkesës.
33. Rrjedhimisht, Gjykata, në bazë të të lartcekurave dhe duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, dhe në bazë të standardeve të vendosura në praktikën e saj gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, pasi nuk i ka shteruar mjetet juridike, përkatësisht parashtruesi i kërkesës nuk ka iniciuar ankesë administrative për zgjidhjen e pretendimeve të tij në gjykatat e rregullta siç përcaktohet në paragrafin 7, të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2, të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe si e tillë, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme.

Përfundim

34. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës përkitazi me pretendimin se, (I) vendimi i kontestuar diskriminon qytetarët e Republikës së Kosovës dhe se (II) parashtruesi i kërkesës mund të jetë personalisht viktimë e shkeljes së Kushtetutës, duhet të shpallet i papranueshëm, sepse (I) nuk është parashtruar nga pala e autorizuar, siç parashihet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (a) të Rregullores së punës dhe (II) nuk janë shteruar mjetet juridike të përcaktuara në paragrafin 7, të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2, të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, dhe si e tillë, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme në tërësinë e saj si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (a) dhe (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 dhjetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani